



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr 1151 Prot.

Gjirokastrë, më 22/09 /2020

VENDIM

Nr. 31 datë 22.09.2020

PËR MIRATIMIN E RIORGANIZIMEVE TË NJËSIVE BAZË
DHE TË GRUPEVE MËSIMORE

Në mbështetje të: nenit 25 pika 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; të nenit 8 të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë; të udhëzimit Nr. 27, datë 29.12.2017 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë", pika 8; urdhërit të Rektorit nr. 45, datë 16.09.2020; vendimit të Dekanatit të FESHSH nr. 6 (gjashtë), datë 17.09.2020; vendimit të Dekanatit të FSHN nr. 5 (pesë), datë 18.09.2020; Vendimit të Rektoratit nr. 10, datë 22.09.2020, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, në mbledhjen e tij të datës 22.09.2020,

VENDOSI

Të miratojë strukturimin e njësive bazë dhe të grupeve të mëposhtme si më poshte:

FSHN


1. Njësia Bazë e Biologjisë dhe Kimisë, e përbërë nga 8 (tetë) personel akademik me kohë të plotë, të funksionoj si njësi e pa strukturuar në grupe mësimore shkencore.
2. Njësia Bazë e Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, e përbërë nga 14 (katërmëdhjetë) personel akademik me kohë të plotë, të funksionoj si njësi e strukturuar në dy grupe mësimore/shkencore:
 - a. Grupi mësimor/kërkimor i Analizës Matematike, Matematikës së Zbatuar dhe Fizikës.
 - b. Grupi mësimor/kërkimor i Algjebër-Gjeometrisë dhe Informatikës

FESHSH

3. Njësia Bazë e Gjuhëve të Huaja, e përbërë nga e përbërë nga 11 (njëmbëdhjetë) personel akademik me kohë të plotë, të funksionoj si njësi e strukturuar në dy grupe mësimore shkencore:
 - a. Grupi mësimor kërkimor i Letërsisë dhe Qytetërimit.

- b. Grupi mësimor kërkimor i Gjuhësisë Teorike dhe Gjuhësisë së Zbatuar
4. Njësia Bazë e Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënjes, e përbërë 9 (nëntë) personel akademik me kohë të plotë, të funksionoj si njësi e pa strukturuar në grupe mësimore shkencore.
5. Njësia Bazë e Historisë dhe Gjeografisë, e përbërë nga e përbërë 9 (nëntë) personel akademik me kohë të plotë, të funksionoj si njësi e pa strukturuar në grupe mësimore shkencore.
6. Të gjitha njësitë e tjara bazë të FSHN, FESHSH, FE, të pa përmendura në pikat 1-5, në të cilat numuri i personelit akademik me kohë të plotë është më pak se 10 (dhjetë), do të vazhdojnë të funksionojnë të pa strukturuar në grupe mësimore shkencore.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjherë dhe u përcillet për zbatim administratorit, zëvendës rektorit për procesin mësimor, dekanëve të njësive kryesore, drejtuesve të njësive bazë, kryesekretares mësimore, sektorit të standarteve dhe korrikulave, Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës Akademike Administrative, Drejtorisë së Shërbimeve Universitare.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK


Prof.dr.Bektash MEMA

